

TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE DHE NDËRMARRJET 2016-2020



www.instat.gov.al

TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE DHE
NDËRMARRJET 2016-2020

Drejtor botimi: **Dr. Elsa Dhuli**

© Copyright INSTAT 2021

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: +355 4 2222 411
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Parathënie dhe Mirënjohje

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), boton për të shtatin vit radhazi publikimin mbi tregtinë e jashtme të mallrave dhe tregtinë e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjes. Ky publikim paraqet jo vetëm tregtinë e jashtme të mallrave, por edhe karakteristikat e ndërmarrjeve të cilat kryejnë këtë tregti.

Me anë këtij publikimi INSTAT është orientuar që të përmbushë nevojat e përdoruesve dhe synon t'u përgjigjet pyetjeve të tilla si: Ç'lloj biznesesh fshihen pas flukseve tregtare të mallrave? Cili është kontributi i një sektori të caktuar aktiviteti në tregti? Sa është pesha e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në tregtinë totale? Sa është pjesa e ndërmarrjeve që tregtojnë me një vend të caktuar partner dhe sasia e vlerës tregtare që ato përbëjnë?

Ky publikim i dedikuar, paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend, si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencor dhe akademikëve në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar falë bashkëpunimit dhe të dhënave administrative të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe politikë-bërësit, rrit përgjegjësinë e INSTAT për hartimin e publikimeve të veçanta dhe informacioneve statistikore që do të shërbenin për të kuptuar më mirë realitetin ekonomik, në mënyrë që të ballafaqohemi me sfidat e së ardhmes.

INSTAT gjithmonë do të ofrojë partneritet të vazhdueshëm dhe një bashkëpunim të frytshëm, ashtu siç e dëshmon dhe ky botim.

Dr. Elsa DHULI

Drejtor i Përgjithshëm, INSTAT

HYRJE.....	7
I. KARAKTERISTIKAT E TREGTISË SË JASHTME TË MALLRAVE.....	9
A. Tregtia e jashtme e mallrave.....	9
B. Tregtia e jashtme e mallrave sipas produkteve.....	9
C. Tregtia e jashtme e mallrave sipas rajoneve kryesore.....	10
D. Tregtia sipas partnerëve kryesorë.....	10
II. TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË NDËRMARRJES, 2016-2020.....	10
A. Tregtia e jashtme e mallrave sipas madhësisë së ndërmarrjes.....	10
B. Sektorët mbizotërues në eksportet/importet e mallrave.....	11
C. Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve.....	11
D. Përqëndrimi i ndërmarrjeve eksportuese/importuese.....	12
E. Ndërmarrjet eksportuese/importuese, sipas numrit të vendeve partnere.....	12
ANEKSI 1:.....	12
METODOLOGJI.....	12

Hyrje

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave janë një instrument shumë i rëndësishëm për marrësit e vendimeve në sektorët publik dhe privat. Ato ndihmojnë në përgatitjen e bisedimeve bilaterale dhe multilaterale në kuadrin e politikave tregtare dhe për vlerësimin e ekonomive të tregut. Ato ndihmojnë gjithashtu kompanitë në studimin e tregut dhe në përcaktimin e strategjive të tyre tregtare. Statistikat mbi tregtinë e mallrave përmbajnë të dhëna mbi eksportet/importet e mallrave në Shqipëri, si edhe statistika të tregtisë së mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve.

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve përmbajnë informacion thelbësor mbi ndërmarrjet të cilat marrin pjesë në tregun ndërkombëtar dhe karakteristikat e tyre si vlerat e eksporteve/importeve dhe numri i ndërmarrjeve. Nëpërmjet lidhjes së statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave me statistikave të ndërmarrjeve kuptojmë kontributin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë, si dhe pjesëmarrjen e ndërmarrjeve e vogla, të mesme dhe të mëdha në transaksionet tregtare. Hartimi i statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve kryhet përmes lidhjes në nivel individual të të dhënave të tregtisë së mallrave me regjistrin statistikor të ndërmarrjeve. Karakteristikat kryesore të ndërmarrjeve nga regjistri statistikor i ndërmarrjeve – si aktiviteti ekonomik dhe numri i të punësuarve – janë të kombinuar me variablat tipikë të të dhënave të tregtisë së mallrave si kodi i produktit dhe vendi partner, duke na dhënë në këtë mënyrë një pamje më të plotë të strukturës së tregtisë së mallrave.

Duke iu referuar periudhës 2016-2020, statistikave në lidhje me tregtinë e mallrave në Shqipëri synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e tregtisë së vendit tonë me botën.

Ky material, i përgatitur nga INSTAT, publikohet i strukturuar në këtë mënyrë, duke përfshirë të dhënat për vitet referencë 2016-2020 dhe do të jetë publikim i vazhdueshëm me frekuencë vjetore.

Materiali përbëhet nga dy kapituj. Kapitulli i parë paraqet informacion mbi shkëmbimin e mallrave ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera të botës.

Kapitulli i dytë ka për objektiv të paraqesë statistika mbi tregtinë e jashtme të mallrave të detajuar sipas kategorive të ndryshme të ndërmarrjeve.

Gjetjet kryesore

Në vitin 2020 eksportet e mallrave janë 272 miliard lekë, duke u ulur 9,0 % krahasuar me vitin 2019. Ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 605 miliard lekë, duke u ulur 6,8 % krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2020 pesha e eksporteve në vendet e BE është 75 % të eksporteve të mallrave, duke arritur vlerën 203 miliard lekë. Eksportet në vendet e BE u ulën me 10,9 % krahasuar me vitin 2019. Pesha e importeve nga vendet e BE është 58 % të importeve të mallrave, duke arritur vlerën 351 miliard lekë. Importet nga këto vende u ulën me 6,1 %, krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2020 partneri ynë kryesor për eksportet dhe importet vazhdon të jetë Italia. Vlera e eksporteve drejt Italisë është 124 miliard lekë, duke u ulur 13,7 % krahasuar me vitin 2019. Ndërsa vlera e importeve nga Italia 152 miliard lekë, duke u ulur 7,4 % krahasuar me vitin 2019.

Numri i ndërmarrjeve eksportuese në vitin 2020 është 2.926, duke u ulur me 8,3 % krahasuar me vitin 2019. Ndërsa numri i ndërmarrjeve importuese është 11.238 ndërmarrje, duke u ulur me 1,1 % krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2020, ndërmarrjet që operojnë në industri dominojnë ndërmarrjet eksportuese. Këto ndërmarrje kryejnë 80 % të vlerës së eksporteve, duke u ulur me 10,9 %, krahasuar me vitin 2019. Ndërmarrjet që operojnë në tregti dominojnë ndërmarrjet importuese në vitin 2020. Këto ndërmarrje kryejnë

58 % të vlerës së importeve, duke u ulur me 3,2 % krahasuar me 2019.

Për vitin 2020, më shumë se gjysmën e eksporteve e kryejnë 100 ndërmarrjet më të mëdha (58 %), ndërsa më shumë se gjysmën e importeve e kryejnë 200 ndërmarrjet më të mëdha (51 %).

Në vitin 2020, dominojnë ndërmarrjet që eksportojnë drejt 1 vendi partner. Ato kryejnë 32 %, të vlerës së eksporteve, ndjekur nga ndërmarrjet që eksportojnë drejt 3-5 vendeve partnere (22 %).

Në vitin 2020, dominojnë ndërmarrjet që importojnë nga 10 ose më shumë vende partnere. Këto ndërmarrje kryejnë 53 % vlerës së importeve, ndjekur nga ndërmarrjet që importojnë nga 3-5 vende partnere (16 %).

Karakteristikat e tregtisë së jashtme të mallrave

A. Tregtia e jashtme e mallrave

Tregtia e jashtme e mallrave

Gjatë vitit 2020 deficit tregtar është përkeqësuar duke u rritur 4,9 % krahasuar me vitin 2019.

Gjatë periudhës 4-vjeçare (2016-2020) vihet re një tendencë rritje e eksporteve 8,7 % mesatarisht në vit dhe importeve 5,6 % meatarisht në vit, duke patur ulje gjatë viteve 2019-2020. Në vitin 2020 pesha e eksporteve është 31 %, duke u ulur 9,0 % krahasuar me vitin 2019. Ndërsa pesha e importeve në vitin 2020 është 69 %, duke u ulur 6,8 % krahasuar me vitin 2019.


B. Tregtia e jashtme e mallrave sipas produkteve

Produktet kryesore

Produktet që zënë një pjesë të konsiderueshme në eksportet dhe importet shqiptare për periudhën 5-vjeçare janë eksportet e mallrave të përpunuara.

Për vitin 2020 më të eksportuara janë grupet e produkteve: “Mallra të përpunuara” me 62 %, duke u ulur me 10,9 %, “Lëndët djegëse” dhe “Makineri dhe pajisje transporti” me 8 %, duke u ulur respektivisht me 31,1 dhe rritur me 6,8 % dhe “Ushqime dhe kafshë të gjalla” me 11 % të eksporteve, duke u rritur me 10,0 % krahasuar me vitin 2019.

Fig.1 Qarkullimi i mallrave në tregtinë e mallrave, 2012-2020 (%)



Tab.1 Eksportet sipas Klasifikimit Standart të Tregtisë së Jashtme (SITC Rev.4), 2016-2020

milionë lekë					
	2016	2017	2018	2019	2020
Gjithsej	243,498	272,988	310,436	298,790	271,955
Ushqime dhe kafshë të gjalla	19,167	24,488	25,867	28,388	31,227
Pije dhe duhan	1,598	1,485	1,793	1,846	1,710
Materiale të papërpunuara	23,289	23,141	18,662	20,582	20,192
Lëndë djegëse	27,397	23,902	41,271	33,322	22,957
Yndyrna bimore dhe shtazore	225	243	246	196	297
Produkte kimike	3,060	3,382	4,523	5,357	5,229
Mallra të përpunuara	44,276	57,828	69,941	63,391	61,118
Makineri e pajisje transporti	11,255	15,118	18,046	20,930	22,360
Mallra të tjera të përpunuara	112,660	123,156	129,836	124,562	106,353
Mallra të paklasifikuara diku tjetër	571	243	250	215	513

Grup produktet që dominojnë importin për vitin 2020 janë: “Mallra të përpunuara” me 36 %, duke u ulur me 8,4 %, “Makineri dhe pajisje transporti” me

22 %, duke u ulur me 3,3 % dhe “Ushqime dhe kafshë të gjalla” me 14 %, duke u rritur 0,8 % krahasuar me vitin 2019.

Tab.2 Importet sipas Klasifikimit Standart të Tregtisë së Jashtme (SITC Rev.4), 2016-2020

milionë lekë					
	2016	2017	2018	2019	2020
Gjithsej	579,248	626,186	641,466	649,111	605,262
Ushqime dhe kafshë të gjalla	73,616	78,268	78,754	82,044	82,736
Pije dhe duhan	18,343	20,272	20,131	20,990	19,553
Materiale të papërpunuara	12,180	18,926	22,255	22,167	22,368
Lëndë djegëse	46,945	61,711	64,661	73,118	50,808
Yndyrna bimore dhe shtazore	5,562	5,202	4,708	4,192	5,242
Produkte kimike	68,618	74,302	74,858	75,483	77,831
Mallra të përpunuara	144,207	146,820	147,595	145,720	136,208
Makineri e pajisje transporti	126,677	131,630	140,301	135,148	130,737
Mallra të tjera të përpunuara	82,390	88,874	88,045	89,750	79,517
Mallra të paklasifikuara diku tjetër	710	181	159	499	263

C. Tregtia e jashtme e mallrave sipas rajoneve kryesore

Në vitin 2020 pesha e eksporteve në vendet e BE është 75 %, duke u ulur me 10,9 % krahasuar me vitin 2019. Ndërsa pesha e importeve nga vendet e BE është 58 % të importeve duke u ulur me 6,1 %, krahasuar me vitin 2019.

Pesha e eksporteve në vendet e CEFTA-s është 18 %, duke u ulur me 5,9 % krahasuar me vitin 2019. Ndërsa pesha e importeve nga vendet e CEFTA-s është 7 % të importeve duke u rritur me 1,9 %, krahasuar me vitin 2019.

D. Tregtia sipas partnerëve kryesorë

Tendenca e partnerëve tregtarë, 2020

Eksportet në vlerë kanë shënuar rritje drejt Greqisë, Gjermanisë, Maqedonisë së Veriut, Serbisë, Francës, etj. Ndërkohë rritje për importet kanë Greqia, Gjermania, Maqedonia e Veriut dhe Kosova.

Në vitin 2020 partnerët tanë kryesorë për eksportet janë: Italia (45 %), duke u ulur me 13,7 % krahasuar me vitin 2019, Kosova (10 %), duke u ulur 12,0 % krahasuar me vitin 2019, Spanja (6 %), duke u ulur 30,4 % krahasuar me vitin 2019.

Partnerët kryesorë për eksportet, 2020




Fig.2 Tregtia e mallrave sipas grupvendeve, 2020




Tab 3. Tregtia e mallrave sipas grup-vendeve

	Eksporte	Importe
Vendet e BE-së	75%	58%
Vendet e CEFTA-s	18%	7%
Vendet e EFTA-s	0%	2%
Vendet e tjera	7%	33%

Partnerët kryesorë për importet janë: Italia (25 %), duke u ulur 7,4 % krahasuar me vitin 2019, Turqia (10 %), duke u ulur 6,2 % krahasuar me vitin 2019, Greqia (9 %), duke u rritur 0,2 % krahasuar me vitin 2019.

Partnerët kryesorë për importet, 2020





II. Tregtia e jashtme e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjes, 2016-2020

A. Tregtia e jashtme e mallrave sipas madhësisë së ndërmarrjes


Ndërmarrjet micro: 1-9 të punësuar,
Ndërmarrjet e vogla: 10-49 të punësuar,
Ndërmarrjet e mesme: 49-250 të punësuar,
Ndërmarrjet e mëdha: + 250 të punësuar.

Në periudhën 2016-2020, numri i ndërmarrjeve eksportuese dhe importuese është rritur. Numri i ndërmarrjeve eksportuese, në vitin 2020, është 2.926, duke u ulur me 8,3 % krahasuar me vitin 2019. Në vitin 2020, pesha e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, është 97 %. Pesha e ndërmarrjeve mikro është 42 %, ndërmarrjet e vogla është 38 %, ndërmarrjet e mesme është 16 % dhe ndërmarrjet e mëdha është 3 %.

Në vitin 2020, numri i ndërmarrjeve importuese është 11.238 ndërmarrje, duke u ulur me 1,1 % krahasuar me vitin 2019. Pesha e ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme është 98 % të ndërmarrjeve importuese gjithsej. Pesha për ndërmarrjet mikro (1-9 të punësuar) është 65 %, ndërmarrjet e vogla është 25 % të ndërmarrjeve importuese gjithsej, ndërmarrjet e mesme është 8 % dhe ndërmarrjet e mëdha është 2 %.



Fig.3 Tregtia e jashtme e mallrave, sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2020



B. Sektorët mbizotërues në eksportet/importet e mallrave

Industria përfshin:


Industri nxjerrëse; Industri përpunuese; Energji elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar; Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve.

Për periudhën 2016-2020, në ndërmarrjet eksportuese mbizotërojnë, ndërmarrjet që operojnë në sektorin e industrisë. Në vitin 2020, pesha e eksporteve të kryera nga ndërmarrjet që operojnë në industri është 80 %, duke u ulur me 10,9 %, krahasuar me vitin 2019. Ndërmarrjet e mëdha zënë 42 % të vlerës së eksporteve të këtyre ndërmarrjeve, duke u ulur me 20,5 %, krahasuar me vitin 2019.

Ndërmarrjet e mëdha zënë 42 % të vlerës së eksporteve të këtyre ndërmarrjeve, duke u ulur me 20,5 %, krahasuar me vitin 2019.

Për periudhën 2016-2020, vlerën më të madhe të importeve e kanë ndërmarrjet që operojnë në sektorin e tregtisë. Në vitin 2020, pesha e këtyre ndërmarrjeve është 58 %, duke u ulur me 3,2 % krahasuar me 2019. Në 2020, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme zënë 89 % të vlerës së importeve të ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e tregtisë, duke u ulur me 5,9 %, krahasuar me vitin 2019.

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas sektorëve, 2020




C. Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve

“Produktet nga përpunimi”, në periudhën 2016-2020 zënë pjesën më të madhe të produkteve të eksportuara dhe të importuara. Në vitin 2020, pesha e eksporteve të këtyre produkteve është 81 %, duke u ulur me 9,2 %, krahasuar me 2019.

Produktet me peshën kryesore në “Produktet nga përpunimi” janë: “Produktet e veshjeve” (24 %), “Produktet e përpunimit të lëkurës” (21 %), si edhe “Produktet e metaleve bazë” (13 %). Ndërsa pesha e importeve të produkteve nga përpunimi është 89 %, duke u ulur me 6,1 %, krahasuar me 2019. Produktet me peshën kryesore në “Produktet nga përpunimi” janë: “Produktet ushqimore” (12 %), “Kimikate dhe produkte kimikate” (8 %) dhe “Makineri dhe pajisje të paklasifikuara në vend tjetër” (7 %).

Fig.5 Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve, 2020 (%)




D. Përqëndrimi i ndërmarrjeve eksportuese/importuese

Në periudhë 2016-2020, më shumë se gjysma e eksporteve ishte e përqëndruara në 50 ndërmarrjet më të mëdha. Për vitin 2020, pesha e 100 ndërmarrjeve është 58 %. Pesha e këtyre ndërmarrjeve që operojnë në industri është 68 %, ndërsa pesha e ndërmarrjeve që operojnë në tregti është 78 %.

Në periudhë 2016-2019, më shumë se gjysma e importeve ishte e përqëndruara në 100 ndërmarrjet më të mëdha. Për vitin 2020, më shumë se gjysmën e importeve e kryejnë 200 ndërmarrjet më të mëdha (51 %). Pesha e këtyre ndërmarrjeve që operojnë në industri është 78 %, ndërsa pesha e ndërmarrjeve që operojnë në tregti është 61 %.

Fig.6 Tregtia e jashtme e mallrave sipas ndërmarrjeve kryesore, 2020




E. Ndërmarrjet eksportuese/importuese, sipas numrit të vendeve partnere

Në periudhë 2016-2020, pjesën më të madhe të eksporteve ndërmarrjet kanë kryer vetëm me 1 vend partner. Në vitin 2020, pesha e eksporteve të këtyre ndërmarrjeve është 32 %, ndjekur nga ndërmarrjet që eksportojnë drejt 3-5 vendeve partnere (22 %).

Ndërsa pjesën më të madhe të importeve, në periudhë 2016-2020, ndërmarrjet kanë kryer me më shumë se 10 vende partnere. Në vitin 2020, pesha e importeve të këtyre ndërmarrjeve është 53 %, ndjekur nga ndërmarrjet që importojnë nga 3-5 vende partnere (16 %).

Fig.7 Tregtia e jashtme e mallrave sipas numrit të vendeve partnere me të cilët kryejnë tregtinë ndërmarrjet, 2020



Aneksi 1:


Metodologji

Burimi i informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është burimi i të dhënave të tregtisë së jashtme të mallrave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është burimi i të dhënave për Regjistrin e Ndërmarrjeve.

Grumbullimi i të dhënave

Në nivelin konceptual, metodologjia e përdorur në grumbullimin dhe vlefshmërinë e të dhënave mund të shpjegohet sipas skemës në vazhdim:



Përkufizime / Koncepte

Përkufizimet dhe konceptet në këtë shpjegues metodologjik janë dhënë në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë lidhjen ndërmjet përmbajtjes së të dhënave të tregtisë së mallrave dhe regjistrit të ndërmarrjeve.

Ndërmarrja është: “Kombinimi më i vogël i njësive ligjore pra një njësi organizative që prodhon të mira apo shërbime që ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)”. Marrëdhënia ndërmjet një ndërmarrje dhe një njësie ligjore përkufizohet si: “ndërmarrja i korrespondon ose një njësie ligjore ose një kombinimi njësisht ligjore”.

Vendi partner në termat e eksporteve është vendi i destinacionit final të mallrave. Për importet është vendi i origjinës së mallrave.

Vendet anëtare të BE-së – Austri, Belgjikë, Bullgari, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Greqi, Gjermani, Hollandë, Hungari, Irlandë, Itali, Kroaci, Letoni, Lituani, Luksemburg, Maltë, Poloni, Portugali, Qipro, Republika Çeke, Ruman, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi;

Vendet anëtare të CEFTA-s – Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedoni, Moldavia, Serbia, Shqipëria;

Vendet anëtare të EFTA-s – Island, Norvegji, Lihtenshtein, Zvicër.

Eksportet janë vlerësuar me FOB (Përfaqëson një kusht të shpërndarjes së mallrave, që tregon se çmimi i mallrave përfshin edhe shpenzimet e transportit dhe të dorëzimit, tek një port i caktuar i ngarkimit). Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, të përpunimit pasiv, të rieksporuara pas përpunimit aktiv.

Importet janë vlerësuar me CIF (Përfaqëson një kusht të shpërndarjes së mallrave, që tregon se çmimi i mallrave përfshin sigurimin dhe transportin, deri tek një port i caktuar destinacion).

Klasifikime

Në përpunimin e informacionit statistikor të tregtisë së jashtme të mallrave mallrave, import-eksportet, është përdorur Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Tregtisë (SITC), i cili i klasifikon mallrat sipas fazave të tyre të prodhimit. Ndërsa për aktivitetet klasifikimi i aktiviteteve ekonomike NVE rev.2 (emërtimi shkurt në anglisht – NACE Rev.2) dhe për produktet klasifikimi statistikor i produkteve sipas aktiviteteve, NP 2008 (emërtimi shkurt në anglisht – CPA 2008).

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti i Statistikave

Tregtia e jashtme e mallrave dhe ndërmarrjet : 2016-2021

= International trade in goods and enterprises : 2016-2021 /

INSTAT ; dr. i bot. Elsa Dhuli.

- Tiranë : INSTAT, 2021

... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-188-92-2

1.Tregtia ndërkombëtare 2.Prodhimi i mallrave

3.Statistika 4.Shqipëri

339.18(496.5) "2016/2021" :311.312